



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit
Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për
vitin 2021

Prishtinë, nëntor 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me raportin e përcjelljes së rekomandimeve të raportit të auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Arben Selimi, Drejtor i Auditimit

Vjosë Bojku, Udhëheqës i ekipit

Atdhe Gashi, Auditor i IT

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme.....	2
Hyrje	4
Objektivi i Përcjelljes së Zbatimit të Rekomandimeve.....	5
Pyetjet e përcjelljes	5
Gjetjet e përcjelljes	6
3.1 Vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve.....	6
3.1.1 Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve	7
3.1.2 Zbatimi i rekomandimeve nga komunat e audituara.....	7
3.1.3 Kanalet e komunikimit në komuna	8
3.1.4 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm për raportim.....	9
3.2 MAPL nuk ishte e përgatitur për raportimin e performancës 2024	11
3.2.1 Rekomandimet e zbatuara nga MAPL-ja.....	13
Konkluzionet.....	17
Shtojca I. Motivi i përcjelljes, kriteret, pyetjet, fushëveprimi dhe metodologjia	18
Motivi i Përcjelljes	18
Pyetjet e përcjelljes	18
Kriteret e përcjelljes:.....	19
Metodologjia e Përcjelljes.....	20
Fushëveprimi dhe kufizimet e përcjelljes	21
Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant.....	21
Shtojca II Letër konfirmimet	25

Shkurtesat

DEMOS - (Decentralization and Municipal Support)

GPK - Granti për Performancë Komunale

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

SMPK - Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit, në vitin 2024, ka publikuar raportin e auditimit të performancës “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021” në mars të vitit 2024. Qëllimi i këtij auditimi ka qenë të vlerësojë efektivitetin e mekanizmave ekzistues për sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara në kuadër të Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale, si dhe menaxhimin e qasjes logjike në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale në tri komuna të përzgjedhura: Gjakovë, Klinë dhe Viti. Gjithashtu, është vlerësuar mënyra se si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kryer verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara nga komunat. Ky raport ka rezultuar me gjithsej 11 rekomandime, tri prej tyre për komunat e përfshira në auditim dhe tetë për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këtë vit Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer përcjelljen e zbatimit të këtyre rekomandimeve, për të përcaktuar nëse veprimet e ndërmarra nga komunat dhe ministria janë në përputhje me qëllimin dhe përmbajtjen e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit 2024.

Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve ka gjetur se vetëm një rekomandim është zbatuar plotësisht, tri janë në fazën përfundimtare të zbatimit, dy kanë filluar të zbatohen ndërsa dy nuk janë adresuar fare. Konkluzioni i përcjelljes është se MAPL dhe komunat kanë punuar për të adresuar rekomandimet, por zbatimi i plotë kërkon ende angazhim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk kishte bërë përgatitjet e nevojshme për të filluar deklarimin e Performancës Komunale për vitin 2024. Kjo ka shkaktuar vonesa të konsiderueshme si dhe pasiguri për kohën e fillimit të raportimit të të dhënave nga komunat. Rrjedhimisht raporti i performancës komunale është publikuar me 4.5 muaj vonesë gjë që ka shtyrë për po aq muaj procesin e vlerësimit të performancës komunale. Përveç kësaj kjo vonesë e ka bërë të pamundur përcjelljen/vlerësimin e plotë të zbatimit të rekomandimeve, pasi që procesi ende nuk ka përfunduar.

Komisioni për vlerësimin e Performancës Komunale ka tejkaluar kompetencat në vlerësimin e performancës së komunave - duke ndryshuar (disa nga) të dhënat që kishin raportuar komunat, pavarësisht se komisioni ishte i autorizuar vetëm të verifikojë dhe përpunojë të dhënat. Kjo ndërhyrje në të dhënat origjinale të komunave paraqet rrezik për plotësinë dhe saktësinë e të dhënave dhe cenon besueshmërinë e vlerësimit të performancës komunale.

Dy nga tri komunat e audituara për raportim kanë shfrytëzuar të dhënat mbi regjistrimin e popullësisë të vitit 2024 - Komuna e Gjakovës dhe Vitisë kishte raportuar performancën komunale me të dhënat e regjistrimit të vitit 2024, vetëm Komuna e Klinës ka raportuar me regjistrimin e popullsisë së vitit 2011. Kjo për shkak se MAPL-ja, nuk e kisha analizuar si duhet situatën për të marrë një vendim të qëndrueshëm lidhur me atë se cilat të dhëna duhet përdorur për raportim. Kjo ka krijuar pasiguri te komunat dhe për pasojë jo konsistencë raportim në

raportim, duke vënë në rrezik krahasueshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave të performancës komunale për vitin 2024.

Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është pajtuar pjesërisht me gjetjet (komenti gjendet i bashkangjitur në shtojcën II të raportit), ndërsa Komunitet Gjakovë, Klinë dhe Viti janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se do të vazhdojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve. Inkurajohen institucionet e audituara të vazhdojnë me implementimin e rekomandimeve.

Hyrje

Institucionet Supreme të Auditimit luajnë rol jetik në kërkim të llogaridhënies nga institucionet publike në raport me administrimin e fondeve publike si dhe ndihmojnë në ngritjen e transparencës lidhur me aktivitetet që zhvillojnë institucionet publike.

Zyra Kombëtare e Auditimit nga viti 2018 ka filluar bashkëpunimin me Helvetas/DEMOS. Pesë auditime janë publikuar bazuar në këtë bashkëpunim. Ato kishin për qëllim vlerësimin e komunave lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit, menaxhimit e projekteve dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Raporti i fundit që ka publikuar Zyra Kombëtare e Auditimit bazuar në këtë bashkëpunim ishte “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”.

Në këtë auditim, fokusi ishte në procesin e funksionalitetit të mekanizmave të kontrollit të cilësisë të vendosura në komuna, vlerësimin e procesit të performancës komunale për Grantin e Performancës Komunale, dhe përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale. Auditimi pat rezultuar me 11 rekomandime, tetë ishin për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nga tri rekomandime për komunat Gjakovë, Klinë dhe Viti.

Rekomandimet janë dhënë me qëllim që entitetet e audituara të përmirësojnë cilësinë dhe saktësinë së raportimit të performancës komunale si dhe të rrisin efikasitetin në menaxhimin e të dhënave.

Në vazhden e bashkëpunimit me Helvetas/DEMOS është vendosur që të përcillet zbatimi i rekomandimeve dhe të vlerësohet se a i kanë zbatuar entitetet e audituara rekomandimet që iu janë dhënë.

Qëllimi i vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve është t’i ofrojë informacion të pavarur Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë, Komunave dhe palëve të tjera të interesit lidhur me masat e ndërmarra nga entitetet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Objektivi i Përcjelljes së Zbatimit të Rekomandimeve

Objektivi i kësaj përcjelljeje është të vlerësohet nëse komunat: Gjakovë, Klinë dhe Viti si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kanë ndërmarrë masa efektive për përmirësimin e mekanizmave të sigurisë dhe cilësisë së të dhënave të raportuara në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale.

Pyetjet e përcjelljes

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit, kemi formuluar pyetjet kryesore në vijim:

- 1. A kanë ndërmarrë komunat masa efektive për të siguruar cilësinë të dhënave të raportuara në SMPK? dhe**
- 2. A ka ndërmarrë MAPL veprimet e duhura për të siguruar se Komunat kanë raportuar të dhëna të sakta, të sigurt dhe të menaxhuara sipas standardeve të sigurisë së informacionit?**

Ky vlerësim i nivelit të zbatimit të rekomandimeve për bazë ka raportin e auditimit të performancës "Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021". Në këtë auditim janë përfshirë katër institucione publike, prej të cilave tre i takojnë nivelit lokal, një nivelit qendror.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i detajuar i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

Gjetjet e përcjelljes

Në këtë kapitull është analizuar niveli i përgjithshëm i ndikimit të zbatimit të rekomandimeve, të dhëna në raportin e auditimit të performancës “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”. Më pas janë vlerësuar aktivitetet e ndërmarra nga komunat dhe MAPL për adresimin e secilit rekomandim në veçanti.

3.1 Vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve

Raporti i Auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021” ka ndikuar pozitivisht në rritjen e përgjegjësisë institucionale dhe në ndërgjegjësimin për rëndësinë e standardizimit të raportimit të performancës komunale.

Ndikimi ka qenë më i dukshëm në MAPL dhe Komunën e Klinës, ku janë ndërmarrë hapa konkretë drejt formalizimit të proceseve të raportimit dhe përmirësimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

Edhe pse Komunat e Gjakovës dhe Vitisë kanë bërë progres, ato ende nuk dokumentojnë mjaftueshëm aktivitetet dhe vazhdojnë të përdorin forma jozyrtare komunikimi. Kjo e vështirëson transparencën dhe ndjekjen e procesit të raportimit. Në formë tabelare ndikimi i auditimit paraqitet kështu.

Tabela 1 Vlerësimi i ndikimit të rekomandimeve

Institucioni Përgjegjës	Nr Rekomandimeve të dhëna	Ndryshimi i Konstatuar	Burimi i Ndikimit
MAPL	8	Përmirësim i mekanizmave të kontrollit dhe raportimit; masa sigurie në SMPK	Auditimi
Komuna e Gjakovës	3	Rritje e ndërgjegjësimit për transparencë; ndryshime organizative	Auditimi + veprimet komunale
Komuna e Klinës	3	Bashkëpunim i forcuar; raporte javore; ndarje e qartë e fushave; transparencë dhe cilësi më e lartë e të dhënave	Auditimi + veprimet e MAPL
Komuna e Vitisë	3	Ndërgjegjësim i rritur për nevojën e koordinimit; disa përmirësime në mbledhjen e të dhënave	Auditimi + veprimet e MAPL

MAPL, si institucion përgjegjës për menaxhimin e performancës komunale dhe për zbatimin e rregullave, ka pasur një ndikim pozitiv të dukshëm, duke përmirësuar mekanizmat e kontrollit dhe sigurinë në SMPK. Përmes këtyre ndryshimeve, ndikimi i auditimit është ndjerë edhe në komunat, të cilat kanë nisur të zbatojnë praktika më të mira në raportim, transparencë dhe koordinim të brendshëm.

3.1.1 Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve

Përcjellja është bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit mbështetës të ofruar nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë evidencat e komunikimit dhe dokumentet zyrtare që dëshmojnë veprimet e ndërmarra. Është përdorur një qasje analitike për të krahasuar veprimet e realizuara me përmbajtjen dhe qëllimin e secilit rekomandim. Gjithashtu, janë realizuar intervista me zyrtarë përkatës për të verifikuar nivelin e zbatimit dhe janë aplikuar kritere të qarta për klasifikimin e statusit të rekomandimeve (e zbatuar, në proces, apo e pazbatuar). Gjithashtu, është paraqitur në mënyrë tabelare edhe niveli i zbatimit të rekomandimeve.

Tabela 2 Vlerësimi i përgjithshëm zbatimit të rekomandimeve

Rekomandimet e dhëna në auditimin e kaluar (2024)	Është zbatuar	Është në fazën finale të zbatimit	Është filluar me zbatim	Nuk është filluar me zbatim	Nuk është adresuar
Rekomandimi 1			✓		
Rekomandimi 2	✓				
Rekomandimi 3			✓		
Rekomandimi 4		✓			
Rekomandimi 5			✓		
Rekomandimi 6					✓
Rekomandimi 7		✓			
Rekomandimi 8	✓				
Rekomandimi 9		✓			
Rekomandimi 10			✓		
Rekomandimi 11					✓

Nga tabela shihet se nga 11 rekomandimet, dy janë zbatuar, tre janë në fazën përfundimtare të zbatimit, katër kanë filluar të zbatohen dhe dy nuk janë adresuar.

3.1.2 Zbatimi i rekomandimeve nga komunat e audituara

Në këtë pjesë paraqitet progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna për tri komuna: Gjakovë, Klinë dhe Viti. Secila prej këtyre komunave ka pasur nga tre rekomandime për t'i zbatuar, të cilat janë dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin paraprak të auditimit. Nga këto tre rekomandime njeri është zbatuar dhe dy tjerët është filluar me zbatim.

Gjendja aktuale e zbatimit të rekomandimeve për këto tri komuna paraqitet në tabelën më poshtë, ku është bërë klasifikimi sipas statusit të rekomandimeve.

Tabela 3 Gjendja e zbatimit të rekomandimeve në komuna

Rekomandimet e dhëna në auditimin e kaluar (2024)	Është zbatuar	Eshtë në fazën finale të zbatimit	Është filluar me zbatim	Nuk është filluar me zbatim	Nuk është adresuar
Rekomandimi 1			✓		
Rekomandimi 2	✓				
Rekomandimi 3			✓		

Rekomandimi i dytë, i cili kishte të bënte me autorizimet e të dhënave nga kryetarët e komunave në tri komunat e audituara, është zbatuar. Ndërsa për rekomandimin e parë dhe të tretë, zbatimi ka filluar dhe gjendja e tyre paraqitet në vijim.

3.1.3 Kanalet e komunikimit në komuna

Përcaktimi i kanaleve të qarta të komunikimit ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunalë dhe kryetarëve të komunave për të siguruar një deklaram transparent dhe të përgjegjshëm të performancës komunale;

Rekomandimi për krijimin e kanaleve të qarta dhe formale të komunikimit ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunalë dhe kryetarëve të komunave ka filluar të zbatohet në komunat e audituara, krahasuar me vitin e kaluar, komunat kanë ndërmarrë disa hapa për ta përmirësuar gradualisht këtë proces.

Në praktikë, në komunat e audituara, kur pranohet njoftimi për hapjen e sistemit të raportimit të performancës komunale, koordinatori komunal së bashku me kryetarin e komunës ftojnë zyrtarët përgjegjës në mbledhje t'u dakorduar dhe angazhuar në procesin e deklaramit të performancës komunale. Në këto raste, zyrtarët lirohen nga aktivitetet e tyre të përditshme, në mënyrë që të fokusohen në deklaramin e performancës komunale brenda afatit kohor.

Megjithatë, mungesa e një procesi të dokumentuar dhe të standardizuar për këtë formë bashkëpunimi bën që praktikat të ndryshojnë nga një komunë në tjetrën dhe të mos sigurohet vazhdimësi në koordinim dhe cilësi të njëjtë në raportim.

Gjendja në komunat e audituara paraqitet kështu:

Komuna e Klinës

Komuna e Klinës paraqet një praktikë më të mirë krahasuar me dy komunat Gjakovë dhe Viti. Komunikimi ndërmjet koordinatorit komunal dhe zyrtarëve raportues zhvillohet përmes raportimeve të rregullta javore te Kryetarin i Komunës, ku raportohet për secilin fushë, tregues dhe të dhënë të deklaruara në SMPK. Në përfundim të procesit, organizohet takim i përbashkët me ekipin raportues, drejtorët e departamenteve dhe shqyrtohen pikët e vetëvlerësimit e po ashtu identifikohen fushat/treguesit që kërkojnë përmirësim në raportimin e vitit të ardhshëm. Megjithatë, përdorimi i kanaleve formale (shkresa zyrtare, procesverbale) mbetet i kufizuar dhe jo i institucionalizuar në të gjitha fazat e raportimit.

Komuna e Gjakovës

Në Gjakovë, komunikimi zhvillohet kryesisht përmes kanaleve joformale, si biseda verbale dhe Viber. Nuk ekziston një sistem i dokumentuar për rrjedhën e informacionit gjatë raportimit dhe nuk organizohen mbledhje të rregullta ndërmjet koordinatorit, zyrtarëve raportues dhe kryetarit përveç takimit fillestar kur hapet sistemi për deklarimin e performances komunale. Edhe pse është ndryshuar vendimi për emërimin e koordinatorit dhe zyrtarëve raportues, ky ndryshim nuk është shoqëruar me formalizim të kanaleve të komunikimit, siç kërkohet nga rekomandimi.

Komuna e Vitisë

Komunikimi në Komunën e Vitisë është më i dobëti ndër komunat e audituara. Komuna nuk ka ndërtuar një strukturë të qartë komunikimi ndërmjet zyrtarëve përgjegjës dhe nuk ka prova të komunikimit të dokumentuar gjatë procesit të raportimit me përjashtim të rasteve ku gjatë mbledhjes së të dhënave haset në vështirësi. Kërkesat për dorëheqje të zyrtarëve raportues e kanë vështirësuar edhe më shumë aktivitetet e raportimit të performancës komunale.

Në tri komunat, komunikimi ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve dhe kryetarëve të komunave vazhdon të bëhet kryesisht në mënyrë jozyrtare, përmes platformave të tilla si Viber, chat-i i SMPK-së, apo biseda verbale. Email-i zyrtar përdoret rrallë dhe vetëm në raste kur hasen vështirësi në mbledhjen e të dhënave. Përjashtuar mbledhjen hyrëse të fillimit të procesit të raportimit, mungojnë mbledhje të dokumentuara gjatë gjithë periudhës së raportimit, dhe nuk ekziston dokumentacion mbështetës që dëshmon koordinimin ndërmjet palëve.

Si pasojë e mungesës së përdorimit të rregullt të mjeteve zyrtare të komunikimit, siç janë email-i, shkresat zyrtare dhe procesverbalet, bashkëpunimi mes zyrtarëve është mbështetur kryesisht në komunikim verbal dhe në platforma joformale, si Viber. Kjo praktikë ka ndikuar negativisht në vlerësimin e rekomandimit duke vështirësuar gjurmimin e rrjedhës së informacionit dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave të raportuara.

3.1.4 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm për raportim

Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave efektivë të kontrollit për sigurimin e cilësisë në të dhënat e raportuara, duke adresuar çështje të tilla si shpërndarja proporcionale e detyrave ndërmjet zyrtarëve raportues dhe sigurimi i dëshmive të komunikimit gjatë gjithë procesit të raportimit.

Zbatimi i rekomandimit për zhvillimin dhe funksionalizimin e mekanizmave të kontrollit lidhur me sigurimin e cilësisë së të dhënave të raportuara ka filluar të zbatohet në komunat e audituara. Komunat e audituara nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë për të shpërndarë në mënyrë proporcionale detyrat ndërmjet zyrtarëve raportues, megjithatë në komuna janë ndërmarrë disa veprime që ndikojnë në adresimin e këtij rekomandimi.

Kryetarët e komunave në Gjakovë dhe Klinë kanë ndryshuar vendimet për emërtimin e grupit për performancë komunale. Ndryshimi nuk vjen si rezultat i ndarjes së punëve ndërmjet zyrtarëve raportues, por lidhet me përshtatjen me rrethanat e reja të krijuara brenda komunave.

Përderisa në Komunën e Klinës vendimi u ndryshua pas dorëheqjes së zyrtares raportuese nga komuna, në Komunën e Gjakovës vendimi ishte ndryshuar për emërimin e koordinatorit të ri dhe për shkak të ndryshimit të organogramit të komunës.

Sigurimi i dëshmive për procesin e raportimit mbetet i kufizuar, përveç në Komunën e Klinës, e cila ka treguar një qasje më të strukturuar duke bërë ndarje të qartë përgjegjësi për fusha për raportimit mes zyrtarëve të komunës. Koordinatori komunal i kishte specifikuar saktë për secilën fushë dhe tregues dokumentet që duhet përdorur për të raportuar.

Në aspektin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë së të dhënave, koordinatorët komunalë nuk mbajnë përgjegjësi për të gjitha fushat e raportimit, për shkak të mungesës së kompetencës profesionale për ti zotuar të gjitha fushat ku raportohet. Ata shprehën se në fushat ku kanë kompetenca procesi i verifikimit të dhënave nuk paraqet vështirësi. ndërsa aty ku koordinatori nuk ka kompetencë, përgjegjësia bie mbi zyrtarët raportues, të cilët i vendosin të dhënat dhe dokumentet përkatëse për treguesit, të cilat më pas rishikohen nga koordinatorët vetëm nëse treguesi është i raportuar dhe dokumentuar.

Sa i përket sigurimit të dëshmive të komunikimit gjatë procesit të raportimit, Gjakova dhe Vitia nuk kishin ndjekur një proces komunikimi që len dëshmi. Zyrtarët raportues i kishin marrë të dhënat nga drejtoritë përkatëse në mënyrë verbale në vend se të përdorin mjete komunikimi si email zyrtar. Vetëm në një rast, kur zyrtarit përgjegjës nuk ju kishte përgjigjur drejtoria përkatëse, ishte përdorur email për ti kërkuar të dhënat dhe dëshmitë mbështetëse duke përfshirë në komunikim edhe kryetarin e komunës. Kështu shumica e të dhënave në komunë të Gjakovës dhe Vitisë janë siguruar në mënyrë verbale, pra komunikimi gjatë procesit të raportimit nuk është siguruar.

Në anën tjetër, Komuna e Klinës ka ndjekur një qasje më të strukturuar, ku koordinatori për çdo javë ka pranuar të dhënat nga zyrtarët raportues me email dhe ka raportuar të kryetari lidhur me progresin e raportimit për secilën fushë dhe tregues. Kjo praktikë kishte përmirësuar kontrollin mbi raportimin dhe gjurmueshmërinë e procesit.

Mungesa e ndarjes së qartë dhe proporcionale të detyrave ndërmjet zyrtarëve raportues ka ndikuar që procesi i kontrollit dhe rishikimit të të dhënave të mos zhvillohet në mënyrë të balancuar dhe të koordinuar. Ndërsa kompetencat e kufizuara profesionale të koordinatorëve komunalë për të mbuluar të gjitha fushat e raportimit kanë bërë që kontrolli i të dhënave të jetë i pjesshëm.

Ndryshimet administrative që janë bërë në vendimet për emërimin e zyrtarëve raportues nuk kanë adresuar në mënyrë efektive këtë rekomandim, duke u fokusuar kryesisht në përshtatje organizative dhe jo në përmirësimin e mekanizmave të kontrollit.

Si rezultat, në komunat e audituara është vënë re mungesë e komunikimit formal dhe gjurmueshmërisë të plotë të procesit të raportimit, sidomos në Gjakovë dhe Viti. . Ndërsa, Komuna e Klinës ka arritur të përmirësojë transparencën dhe cilësinë e komunikimit gjatë raportimit përmes ndarjes së qartë të fushave dhe kërkesave të dokumentuara për secilin tregues, duke rritur kontrollin dhe llogaridhënien në këtë proces.

3.2 MAPL nuk ishte e përgatitur për raportimin e performancës 2024

Në këtë pjesë paraqitet se si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka adresuar tetë rekomandimet. Gjithashtu këtu kemi vlerësuar procesin e raportimit të performancës komunale për vitin 2024 me theks në përgatitjet teknike dhe administrative të MAPL-së dhe ndikimin e tyre në funksionimin e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Performancës Komunale. Tutje, shqyrtohen vonesat dhe mungesa e koordinimit në udhëzimet për përdorimin e të dhënave statistikore nga komunat, si dhe si këta faktorë kanë ndikuar në cilësinë, transparencën dhe llogaridhënien e raportimit të performancës komunale. Në këtë pjesë paraqitet edhe numri i komunave që kanë shprehur ankesa gjatë procesit të vlerësimit preliminar të performancës komunale.

Ministria duhet të kryejë të gjitha përgatitjet për fillimin e deklarimit të performancës komunale. Deklarimi fillon me datë një shkurt në mënyrë që të arrij të publikoj raportin e performancës komunale me datë 30 maj.

Pavarësisht se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kishte dërguar njoftimin për fillimin e procesit të raportimit të performancës komunale me vetëm dy ditë vonesë, ajo nuk kishte bërë përgatitjet e domosdoshme teknike dhe administrative për të mundur një proces të qartë, të strukturuar dhe të pandërprerë të raportimit.

Aktivitete dhe afatet përkatëse që duhet ndjekë MAPL, sipas Dokumentit Kryesor, dhe si janë zhvilluar ato gjatë vitit 2025 janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

Tabela 4 Afatet e procesit të deklarimit të performancës komunale

Aktiviteti	Koha sipas Dokumentit Kryesor	Koha aktuale
MAPL njofton komunat se ka filluar procesi i matjes së performancës	1 shkurt 2025	3 shkurt 2025
MAPL bën kërkesën për raportim	15 shkurt 2025	6 Maj 2025
Komunat raportojnë të dhënat (përfshirë autorizimin e të dhënave nga Kryetari i Komunës) dhe konsultimi paraprak	45 ditë (deri me 30 mars 2025)	53 ditë (deri me 27 qershor 2025)
MAPL përpunon, analizon dhe verifikon të dhënat e raportuara	25 Prill 2025	Korrik 2025
MAPL njofton për të dhënat e përpunuara të performancës për secilën komunë	30 prill 2025	28 korrik 2025
Periudha për ankesa	20 maj 2025	20 gusht 2025
MAPL publikon raportin vjetor të performancës komunale	30 maj 2025	16 tetor 2025

Tabela prezanton vonesat e secilit aktivitet, duke filluar nga:

Kërkesa për raportim nga MAPL ishte planifikuar për 15 shkurt 2025, por u dërgua më 6 maj 2025, me vonesë 80 ditë. Një vonesë e tillë ka ndikuar drejtpërdrejt në gjithë ciklin e raportimit mbi performancën komunale, duke shtyrë grumbullimin dhe verifikimin e të dhënave, dhe me automatizëm ka ndikuar në të gjitha proceset e tjera që varen nga raportimi në kohë.

Vonesat në hapjen e sistemit dhe në deklarimin e të dhënave nga komunat ndodhën sepse MAPL nuk kishte përfunduar me kohë procedurat e prokurimit për kontraktimin e mirëmbajtjes së Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK). Kontrata paraprake për mirëmbajtjen e SMPK-së kishte skaduar në maj 2024, ndërsa kërkesa për nisjen e procedurës për kontratën e re ishte bërë me tre shkurt 2025, ditën e njëjtë kur MAPL e dërgon njoftimin për raportim tek komunat. Procesi i prokurimit merr kohë, normalisht një deri në dy muaj, mirëpo në këtë proces kishte edhe ankesa, që i kushtuan MAPL-së me më shumë vonesa (rreth 3 muaj). Kontrata e re u lidh në maj 2025, duke kaluar kështu të gjitha afatet kohore që MAPL vetë kishte paraparë. Si pasojë e kësaj vonese, SMPK nuk ishte i gatshëm për përdorim për raportuesit komunal sepse paraprakisht MAPL duhej të bënte ndryshime në sistem, të cilat ishin thelbësore për funksionimin e duhur të tij gjatë procesit të raportimit.

Shkakun kryesor të kësaj situate ishte se MAPL nuk kishte bërë planifikimin me kohë të buxhetit për mirëmbajtjen e SMPK-së, si dhe fillimi me vonesë i procedurës së prokurimit.

Ky proces përfaqëson një vonesë prej tre muaj, e cila ka ndikuar në shtyrjen gjithë ciklit të deklarimit dhe vlerësimit të performancës komunale dhe duke penguar marrjen në kohë të masave për përmirësim.

Komisioni për Vlerësimin e Performancës Komunale, gjatë vlerësimit të performancës, ka tejkaluar kompetencat e tij të përcaktuara me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL, duke ndërhyrë në të dhënat e raportuara nga komunat lidhur me numrin e banoreve. Komunat e kishin raportuar numrin e banorëve sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 (bazuar në udhëzimin fillestar të MAPL). Kjo e dhënë paraqitet në katër tregues⁶. Sipas vendimit komisioni është i autorizuar të verifikojë dhe përpunojë të dhënat e raportuara. Megjithatë komisioni kishte bërë ndryshime në përmbajtjen e të dhënave të raportuara në këta katër tregues, pa i njoftuar komunat lidhur me ndryshimin (numri i popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011).

Shqyrtimi i ankesave ishte bërë përgjatë muajit gusht, 19 nga 33 komunat raportuese ishin ankuar për vlerësimin preliminar të performancës komunale, në 92 tregues. Komisioni për shqyrtimin e ankesave kishte dhënë këto përgjigje:

- Janë aprovuar ankesat për 32 tregues,
- Janë refuzuar ankesat për 59 tregues,
- Ndërsa vlerësimet për 4 tregues kanë mbetur të pandryshuara.

⁶ Treguesit 3.1.2 ; 3.1.7; 4.1.2 dhe 8.1

Një nga arsyet për numrin e madh të ankesave është pasi që SMPK ka pësuar ndryshime, e në disa raste edhe formulat për kalkulim nuk ishin të sakta (ndërrimi i kontraktuesit për mirëmbajtjen e SMPK). Ndryshimet në pikët e treguesve në favor të komunave kanë ndodhur pas shqyrtimit nga komisioni i ankesave sa herë që kishte konstatuar se dëshmitë e bashkangjitura në sistem e mbështetnin treguesin që kishin raportuar komunat.

Bazuar në ankesat e komunave në një rast komisioni kishte konstatuar që një tregues (3.1.7) nuk ishte konfiguruar në sistem si duhet për pasojë të dhënat nuk ishin vlerësuar saktë. Prandaj janë bërë edhe ndryshimet në SMPK.

Raporti vjetor i performancës komunale për vitin 2024 ishte planifikuar të publikohej më 30 maj 2025, por u publikua vetëm më 16 tetor 2025, duke shkaktuar një vonesë prej rreth 4.5 muajsh.

Fillimisht, MAPL u kërkoi komunave të raportojnë të dhënat duke u bazuar në shifrat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2024. Komuna e Drenasit kishte sugjeruar të vazhdojnë të përdorin shifrat e vitit 2011, por MAPL e refuzoi sugjerimin dhe kërkoi përdorimin e të dhënave të vitit 2024. Komunat filluan raportimin sipas këtij udhëzimi. Megjithatë, në ditën e fundit të afatit të rregullt për raportim (19 qershor), MAPL u dërgoi njoftim me email dhe kërkoi që komunat të përdornin shifrat e vitit 2011, pa dhënë shpjegim ose pa nxjerrë vendim zyrtar. Ky ndryshim i fundit ka ndodhur, me qëllim që të dhënat e raportuara në SMFK të jenë në harmoni me dhënat që ishin përdorë për planifikimet buxhetore për vitin 2024 (ndarja e buxhetit për vitin 2024 ishte bazuar në shifrat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011).

Pasojë e mos koordinimit me kohë nga MAPL, është se dy nga tre komunat e audituara raportuan me të dhënat e vitit 2024, ndërsa vetëm Komuna e Klinës i përditësoi të dhënat sipas kërkesës së fundit.

Kjo situatë krijoi konfuzion dhe pasiguri në nivel komunal, duke nxjerrë në pah mungesën e koordinimit dhe standardizimit në nivel qendror.

3.2.1 Rekomandimet e zbatuara nga MAPL-ja

Në këtë pjesë do të paraqesim gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e vitit 2024. Nga tabela shihet se vetëm një rekomandim është zbatuar plotësisht, tri ndodhen në fazën përfundimtare të zbatimit, dy kanë filluar të zbatohen, ndërsa dy një ende nuk janë adresuar.

Kjo gjendje tregon përpjekjet e MAPL-së, për të implementuar rekomandimet e auditimit, por gjithashtu evidenton nevojën për forcim të mëtejshëm të mekanizmave të monitorimit dhe koordinimit për të siguruar zbatim të plotë dhe të qëndrueshëm të rekomandimeve.

Tabela në vijim paraqet gjendjen e rekomandimeve të adresuara nga MAPL-ja.

Tabela 5 Gjenda e zbatimit të rekomandimeve në MAPL

Rekomandimet e dhëna në auditimin e kaluar (2024)	Zbatuar	Zbatimi në fazën përfundimtare ⁷	Zbatimi ka filluar	Zbatimi nuk ka filluar	I pa adresuar
Rekomandimi 4		✓			
Rekomandimi 5			✓		
Rekomandimi 6					✓
Rekomandimi 7		✓			
Rekomandimi 8	✓				
Rekomandimi 9		✓			
Rekomandimi 10			✓		
Rekomandimi 11					✓

Rekomandimi 4 - Adresimi i mangësive në proceset e pranimi dhe vlerësimit të të dhënave të raportuara nga komunat të cilat duhet të jenë të plota, të sakta dhe të miratuara nga kryetarët e komunave.

Ky rekomandim ishte në fazën përfundimtare të zbatimit. Nga 33 komuna që kishin raportuar vetëm kryetarët e komunave Kllokot, Novobërdë dhe Partesh nuk i kishin autorizuar të dhënat. Kryetari i Komunës së Parteshit përmes një shkrese drejtuar MAPL-së kishte njoftuar se të dhënat ishin autorizuar gabimisht nga koordinatori dhe sistemi nuk i jep mundësi rikthimi për përmirësim të gabimit që nënkupton se rekomandimi është marrë parasysh por për çështje pakujdesie dhe teknike nuk ka arritur të zbatohet.

Rekomandimi 5 -komisionet që vlerësojnë Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale janë të autorizuar me vendim. Çdo ndryshim pas lëshimit të autorizimit dokumentohet. Kjo do të ruajë transparencën dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimit.

Ky rekomandim ka filluar të zbatohet. Ai i prekë të gjitha fazat e raportimit deri në dhënien e grantit të performancës komunale, mirëpo është vlerësuar vetëm deri në fazën e publikimit të raportit të performancës komunale, pasi aktivitetet pasuese ende nuk janë zhvilluar. Deri në këtë fazë, MAPL ka autorizuar dy komisione, anëtarët e të cilave kanë vepruar në përputhje me vendimin dhe raportin e përgatitur nga këto komisione.

Rekomandimi 6 - zyrtarët përgjegjës duhet të kryejnë verifikimin fizik në procesin e vlerësimit të performancës komunale në mënyre që të parandaloj deklarimin e gabuar dhe pa dëshmi.

Rekomandim i pa adresuar

Rekomandimi 7 - Autorizimet e qasjeve në SMPK duhet të bëhen sipas niveleve (LIGJI NR. 08/L-103). Për administrimin e aplikacionit të SMPK-së të caktojë një zyrtar të përhershëm

⁷ Zbatimi në fazën përfundimtare – Masat e duhura janë ndërmarrë nga i audituari në drejtim të zbatimit të rekomandimit dhe zbatimi është në fazën përfundimtare për të përfunduar plotësisht.

dhe një zyrtar alternativ dhe këta zyrtarë nuk duhet të jenë të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës komunale.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, për faktin se MAPL ka emëruar zyrtarin e përhershëm, ndërsa mungon emërimi i një zyrtari alternativ. Ministria nuk ka caktuar një zyrtar alternativ për administrimin e sistemit SMPK. . Si pasojë, funksioni i administrimit të sistemit varet vetëm nga një zyrtar duke rritur rrezikun e ndërprerjeve në raste të caktuara.

Mungesa e një zyrtari alternativ për administrimin e sistemit të SMPK-së paraqet rrezik të ndërprerjes së funksionimit normal të sistemit. Në rast mungese, dorëheqje apo pamundësie të zyrtarit përgjegjës për të kryer detyrat e tij/saj sistemi mund të mbes pa administrator. Kjo situatë e lë SMPK-në në varësi të një individ të vetëm, rrezikon vazhdimësinë operacionale dhe mund të ndikojë negativisht në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit, që përfundimisht mund të çojë në mos përmbushjen në kohë të detyrimeve ligjore dhe administrative të Ministrisë.

Rekomandimi 8 - Pasivizimin e llogarisë së kontraktuesit (OE-së) për qasje të plotë në aplikacion real përveç qasjeve vetëm për lexim, me vendim të veçantë dhe mbikëqyrje nga ana e Ministrisë.

Rekomandimi i zbatuar.

Rekomandimi 9 - në SMPK të bëhet konfigurimi për të kufizuar përdoruesin me rolin “Koordinator i performancës komunale” të menaxhojë llogaritë e përdoruesve të Komunës në sistem, si dhe konfigurimi për t’i detyruar përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimin pas aktivizimit të llogarisë dhe qasjes së parë në sistem dhe numri i karaktereve të fjalëkalimit të jetë kompleks me të paktën tetë (8) karaktere;

Rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar. Ministria ka konfiguruar SMPK-në që automatikisht t’i kërkojë zyrtarëve komunalë të ndryshojnë fjalëkalimet kur hyjnë në sistem për herë të parë. Numri i karaktereve të fjalëkalimit është tetë dhe është kompleks. Përveç kësaj çdo herë që hyjnë në sistem, zyrtarëve u dërgohet një kod verifikues në adresën elektronike, si pjesë e mekanizmit të autentikimit me dy faktorë (2FA).

Zbatimi i pjesshëm i rekomandimit sa i përket sigurisë në sistemin SMPK, është sepse nuk është zbatuar kufizimi për rolin “Koordinator i performancës komunale”. Përdoruesit me këtë rol vazhdojnë të kenë qasje në sistem si “administrator”, që është qasje më e gjerë sesa është e nevojshme. Kjo u lejon atyre mundësinë për ndërhyrje të paautorizuara ose përdorim të papërshtatshëm të llogarive të përdoruesve të komunave gjë që mund të çënojë besueshmërinë dhe sigurinë e të dhënave të sistemit.

Mos konfigurimi i SMPK për të kufizuar rolin “Koordinator i performancës komunale” ka ndodhur për shkak se Ministria nuk ka përfunduar plotësisht procesin e përshtatjes së të dhënave të koordinatorëve të sistemit. Po ashtu, nuk janë përcaktuar qartë përgjegjësit për administrimin e roleve të përdoruesve, gjë që ka bërë që zbatimi të mbetet i pjesshëm – vetëm për menaxhimin e fjalëkalimeve.

Rekomandimi 10 - SMPK të pasivizojë llogaritë jo të personalizuar dhe krijimi i llogarive të jetë i standardizuar dhe i personalizuar. Të rishikojë të drejtat e qasjes së përdoruesve të SMPK-së në baza periodike për t'u siguruar që ato janë të vlefshme sipas vendimeve të Ministrisë dhe Komunës.

Ky rekomandim ka filluar të zbatohet. Krijimi i llogarive në SMPK për zyrtarët është i standardizuar dhe i personalizuar. Të gjitha llogaritë gjenden brenda rrjetit qeveritar, me domen shtetëror dhe me email zyrtar (@rks-gov.net). Megjithatë, MAPL nuk ka një procedurë të rishikimit periodik të të drejtave të qasjes së përdoruesve. E drejta për qasje e përdoruesve merret parasysh vetëm njëherë, në momentin kur hapet sistemi, kur komunave u kërkohet t'i dërgojnë vendimet mbi emërimin e zyrtarëve raportues bashkë me koordinatoren e komunës.

Rekomandimi 11 - Organizimin e trajnimeve për zyrtarët që menaxhojnë llogaritë në SMPK mbi standardet për krijimin e llogarive elektronike dhe proceset e rishikimit periodik

Rekomandim i pa adresuar.

Konkluzionet

Auditimi i performancës kishte ndikim të dukshëm në përmirësimin e funksionimit të komunave dhe të MAPL-së. Rekomandimet kanë nxitur ndërgjegjësim më të madh për transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin të metodologjisë së njësuar në raportimin e performancës. Megjithatë, ndikimi nuk ishte i njëjtë në të gjitha institucionet e audituara. Përderisa është i dukshëm në Klinë, në Gjakovë dhe Viti është më i kufizuar për shkak të mungesës së dokumentimit të komunikimit formal.

Nga rekomandimet e dhëna në auditimin e paraprak, vetëm një rekomandim është zbatuar plotësisht, tri janë në fazën përfundimtare të zbatimit, dy kanë filluar të zbatohen, ndërsa dy ende nuk janë zbatuar. Kjo tregon një progres të pjesshëm, ku MAPL dhe komunat po punojnë për të adresuar rekomandimet, por zbatimi i plotë ende kërkon angazhim.

Komuna e Klinës ka treguar progres më të lartë duke forcuar bashkëpunimin mes zyrtarëve komunal, duke bërë raportime javore dhe duke dhënë shembull të praktikës së mirë në procesin e raportimit. Komunat e Gjakovës dhe Vitisë kanë bërë ndryshime të kufizuara dhe vazhdojnë të ballafaqohen me sfida në dokumentimin e procesit të komunikimit dhe koordinimit. Kjo tregon se komunat kanë nevojë ende për mbështetje nga MAPL-ja.

Komunat ende nuk përdorin kanale të qarta dhe të formalizuara të komunikimit mes zyrtarëve raportues, koordinatorëve dhe kryetarëve. Mungesa e këtij komunikimi zyrtar e vështirëson gjurmueshmërinë e raportimeve. Megjithëse ndërgjegjësimi në komuna për ekzistencën e këtij problemi është rritur, veprimet konkrete për zgjidhjen e tij janë ende në fillim.

MAPL nuk ka siguruar me kohë përgatitjen e sistemit për raportimin e performancës për vitin 2024, duke shkaktuar vonesa dhe konfuzion në komunat e audituara. Ndryshimet e fundit në udhëzime për përdorimin e të dhënave të regjistrimit të popullsisë krijuan pasiguri te komunat lidhur me të dhënat që duhet raportuar.

Përveç kësaj vonesat në prokurim dhe koordinimi jo i duhur brendshëm në MAPL ka penguar zbatimin e plotë dhe efektiv të disa rekomandimeve, duke ndikuar drejtpërdrejt në procesin e raportimit të performancës komunale.

Shtojca I. Motivi i përcjelljes, kriteret, pyetjet, fushëveprimi dhe metodologjia

Motivi i Përcjelljes

ZKA dhe DEMOS/Helvetas kanë arritur marrëveshje që të bëhet përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021”. Ky raport pat rezultuar me 11 rekomandime, tri drejtuar Komunave të përfshira në auditim dhe tetë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me synimin për të përmirësuar cilësinë e raportimit dhe menaxhimin e performancës në nivel lokal.

Auditimi përcjellës është i domosdoshëm për të vlerësuar nëse masat që kanë ndërmarrë Komunitat dhe MAPL pas publikimit të raportit të auditimit janë efektive, si dhe për të ndihmuar në forcimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe rritjen e ndikimit të auditimeve të performancës në përmirësimin e qeverisjes lokale.

Pyetjet e përcjelljes

Për t’ju përgjigjur objektivit të auditimit, ne kemi parashtruar pyetjet dhe nën-pyetjet e auditimit:

1. **A kanë ndërmarrë komunitat masa efektive për të siguruar cilësinë të dhënave të raportuara në SMPK?**
 - A janë përcaktuar dhe funksionalizuar kanale të qarta të komunikimit ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve dhe kryetarëve të komunave?
 - A ka një proces sistematik për miratimin e të dhënave nga kryetari i komunës para dorëzimit në SMPK?
 - A funksionojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar raportim të saktë, të dokumentuar dhe të dëshmuar?
2. **A ka ndërmarrë MAPL veprimet e duhura për të siguruar se Komunitat kanë raportuar të dhëna të sakta, të sigurt dhe të menaxhuara sipas standardeve të sigurisë së informacionit?**
 - A janë adresuar mangësitë në procesin e pranimit dhe vlerësimit të të dhënave nga komunitat?
 - A ka kontroll të duhur MAPL-ja mbi SMPK dhe skemën e GPK-së në lidhje me autorizimet dhe qasjet në sistem?

- A ka ndërmarrë MAPL masa për konfigurimin dhe menaxhimin e sigurt të llogarive të përdoruesve në SMPK (p.sh., personalizim, ndërrim i detyrueshëm i fjalëkalimit, rishikim periodik i qasjeve përfshirë dhe trajnimet për zyrtarët përgjegjës,)?

Kriteret e përcjelljes:

Kriteret e auditimit për komunitat

- Përcaktimi i kanaleve të qarta të komunikimit ndërmjet zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunalë dhe kryetarëve të komunave për të siguruar një deklaram transparent dhe të përgjegjshme të performancës komunale;
- Krijimi i një procesi sistematik për miratimin e të dhënave të raportuara nga kryetarët e komunave, duke theksuar rëndësinë e rolit të tyre në miratimin e të dhënave të raportuara; dhe
- Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmave efektivë të kontrollit për sigurimin e cilësisë në të dhënat e raportuara, duke adresuar çështje të tilla si shpërndarja proporcionale e detyrave ndërmjet zyrtarëve raportues dhe sigurimi i dëshmive të komunikimit gjatë gjithë procesit të raportimit.

Kriteret e auditimit për Ministrinë

- Adresimi i mangësive në proceset e pranimit dhe vlerësimit të të dhënave të raportuara nga komunitat të cilat duhet të jenë të plota, të sakta dhe të miratuara nga kryetarët e komunave;
- komisionet që vlerësojnë Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale janë të autorizuar me vendim. Çdo ndryshim pas lëshimit të autorizimit dokumentohet. . Kjo do të ruajë transparencën dhe besueshmërinë e procesit të vlerësimit;
- zyrtarët përgjegjës duhet të kryejnë verifikimin fizik në procesin e vlerësimit të performancës komunale në mënyre që të parandaloj deklaramin e gabuar dhe pa dëshmi;
- Autorizimet e qasjeve në SMPK duhet të bëhen sipas niveleve (LIGJI NR. 08/L-103). Për administrimin e aplikacionit të SMPK-së të caktojë një zyrtar të përhershëm dhe një zyrtar alternativ dhe këta zyrtarë nuk duhet të jenë të përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës komunale;
- Pasivizimin e llogarisë së OE-së për qasje të plotë në aplikacion real përveç qasjeve vetëm për lexim, me vendim të veçantë dhe mbikëqyrje nga ana e Ministrisë;
- SMPK që të bëhet konfigurimi për të kufizuar përdoruesin me rolin “ Koordinator i performancës komunale” të menaxhojë llogaritë e përdoruesve të Komunës në sistem,

si dhe konfigurimi për t'i detyruar përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimin pas aktivizimit të llogarisë dhe qasjes së parë në sistem dhe numri i karaktereve të fjalëkalimit të jetë kompleks me të paktën tetë (8) karaktere;

- SMPK të pasivizojë llogaritë jo të personalizuar dhe krijimi i llogarive të jetë i standardizuar dhe i personalizuar. Të rishikojë të drejtat e qasjes së përdoruesve të SMPK-së në baza periodike për t'u siguruar që ato janë të vlefshme sipas vendimeve të Ministrisë dhe Komunës; dhe
- Organizimin e trajnimeve për zyrtarët që menaxhojnë llogaritë në SMPK mbi standardet për krijimin e llogarive elektronike dhe proceset e rishikimit periodik.

Për çdo rekomandim, zbatimi do të klasifikohet në këto nivele:

I zbatuar – Rekomandimi është zbatuar me sukses.

Zbatimi ka filluar – Disa masa janë ndërmarrë në drejtim të implementimit të rekomandimit, mirëpo progresi i zbatimit është ende në fazë të hershme.

Zbatimi në fazën përfundimtare – Masat e duhura janë ndërmarrë nga i audituari në drejtim të zbatimit të rekomandimit dhe zbatimi është në fazën përfundimtare për të përfunduar plotësisht.

Zbatimi nuk ka filluar – Deri tani nuk është ndërmarrë asnjë masë nga ana e të audituarit për të zbatuar rekomandimin, mirëpo është prezantuar një plan veprimi.

I pa adresuar – Nuk janë marrë masa dhe nuk është prezantuar asnjë plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve.

Nuk aplikohet më – Për shkak të ndryshimeve përbrenda strukturës së së audituarit ose për ndonjë arsye tjetër, rekomandimi nuk është më relevant për të audituarin

Metodologjia e Përcjelljes

Metodologjia e auditimit përfshin ekzaminimin e dokumentacionit të dosjes për deklarimin e performancës komunale, vlerësimin e mekanizmave të kontrollit brenda Komunës dhe vlerësimin e treguesve nga MAPL-ja. Për të audituar këto, ne do të përdorim qasje të kombinuar të auditimit të performancës dhe pajtueshmërisë, duke përfshirë:

Mbledhjen dhe analizimin e të dhënave/dokumenteve

- Dokumentacioni zyrtar lidhur me procedurat e raportimit siç janë, vendimet e kryetarëve të komunave, procesverbale të komisioneve, evidencat e verifikimit fizik;
- Politikat dhe procedurat për menaxhimin e qasjeve të përdoruesve të SMPK;

- Politikat dhe procedurat për rishikimin periodik të përdoruesve dhe kontrolleve kompensuese në SMPK;
- Raportin e rishikimit periodik të listës së përdoruesve me qasje në SMPK; dhe
- Trajnimet dhe materialet mbështetëse si listat e pjesëmarrësve në trajnime, agjenda dhe materialet trajnuese.

Analiza e kontrolleve në SMPK

- Listën e llogarive aktive dhe pasive të përdoruesve dhe administruese në aplikacion dhe bazën e të dhënave të SMPK-së, së bashku me të dhënat për qasjen e fundit dhe ndryshimin e fundit të fjalëkalimit dhe rolet e tyre në SMPK;
- Listën me aktivitet e përdoruesve, gjurmët e auditimit për periudhën e raportimit (45 ditë kalendarike) të performancës komunale;

Intervistat

- Me zyrtarët raportues dhe koordinatorët komunal; dhe
- Me zyrtarë të ministrisë si administratorët e SMPK dhe drejtues të divizioneve të performances komunale;

Testimi i Kontrollit të Brendshëm

- Vlerësim nëse zbatohen praktikat e ndarjes së detyrave; dhe
- Nëse ka dokumentim për miratimin dhe komunikimin e të dhënave.

[Fushëveprimi dhe kufizimet e përcjelljes](#)


Fushëveprimi i përcjelljes së rekomandimeve përfshin vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve në raportin e auditimit "Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021" i publikuar në vitin 2024. Ky vlerësim do të fokusohet në masat e ndërmarra nga tri komunat: Gjakovë, Klinë dhe Viti si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e rekomandimeve.

[Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant](#)

Auditimi përcjellës përbën një komponent thelbësor në sigurimin e ndikimit të auditimit të performancës dhe konsolidimin e përgjegjshmërisë institucionale për zbatimin e rekomandimeve. Ky proces është i strukturuar në disa faza të ndërlidhura, të cilat shpjegohen më poshtë dhe janë paraqitur në mënyrë vizuale në Diagramin 1.

Hapat që duhet ndjekur në auditimin përcjellës janë paraqitur në diagramin numër 1.

Diagrami 1 Procesi i auditimit përcjellës



Identifikimi i Rekomandimeve që duhet përcjellë

Procesi nisë me identifikimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës. Kjo fazë menaxhohet nga udhëheqësi i ekipit të auditimit ose një auditor tjetër i caktuar nga drejtuesit e ZKA-së. Qëllimi është të sigurohet që rekomandimet të trajtohen nga entitetet e audituara dhe të mos mbeten vetëm në dokument.

Plani i Veprimit

Pas pranimit të rekomandimeve, subjekti i audituar harton një plan veprimi, i cili përshkruan hapat konkret për zbatimin e secilit rekomandim, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Ky plan veprimi i dërgohet ZKA-së dhe shërben si bazë për monitorimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve.

Veprimet e Ndërmarra

Në këtë fazë subjekti i audituar kalon nga planifikimi në zbatim të masave/veprimeve të parapara. ZKA, përmes auditimit përcjellës, shqyrton këto masa/veprime për të vlerësuar nëse janë adresuar në mënyrë efektive çështjet e ngritura në auditim.

Gjendja e Re

Pas ndërmarrjes së veprimeve, krijohet një gjendje e re, që duhet të reflektojë përmirësim krahasuar me gjendjen fillestare. Nëse rekomandimet janë zbatuar me sukses, ato shënohen si të përmbushura dhe dokumentohet gjendja e re institucionale si rezultat i zbatimit të rekomandimeve.

Rezultatet e përcjellës së rekomandimeve

Në fund të procesit, ZKA raporton për:

- Numrin dhe përqindjen e rekomandimeve të zbatuara, plotësisht ose pjesërisht;
- Çështjet që kanë mbetur pa trajtuar dhe rekomandimet e përsëritura, në rast se nuk ka pasur përmirësim;
- Ndikimin e rekomandimeve në përmirësimin e qeverisjes.

Ky proces ndihmon në ndërtimin e një kulture llogaridhënieje dhe transparence në administratën publike.

Shtojca II Letër konfirmimet



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Dt. 12.11.2025
Gjakovë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”, (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe konkluzionet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit



Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me gjetjet dhe konkluzionet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i Komunës

Zenun Elezaj



Datë: 06.11.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar dhe miratuar më datën: 14-11-2025			
No. i propozit	Thema e Propozit	Shprehja e Propozit	Vlera e Propozit
02-016/01-1718			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe konkluzionet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Sokol Haliti

Kryetari i komunës së Vitisë

Data: 14.11.2025





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021”
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Për Z. Elbert Krasniqi

Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Data: 13.11.2025



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombetare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Auditimi i kryer: Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021

Dokumenti: Komentet nga institucioni i audituar në draft raportin e auditimit

Te gjeturat	Pajtohem po/ jo	Komentet nga nstitucioniiaudituar ne raste te mos pajtimi	Pikepamja e ZKA-se
Gjetja 3.2 Komisioni për Vlerësimin e Performancës Komunale ka tejkaluar kompetencat duke ndryshuar të dhënat e raportuara nga komunat pa i njoftuar komunat lidhur me ndryshimin	JO	MAPL nuk pajtohet me termin "tejkallim i kompetencave". <i>Sqarim:</i> Komisioni nuk ka tejkaluar kompetencat duke ndryshuar të dhënat e raportuara nga komunat pa i njoftuar lidhur me ndryshimin (numri i popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011). Vendimi për përdorimin e të dhënave të regjistrimit 2011 është marrë për të ruajtur koherencën me ndarjet buxhetore të vitit 2024, të cilat ishin bazuar në të njëjtat shifra. Ndryshimi është komunikuar me email të gjitha komunave për të shmangur mosperputhjet. Ndryshimet e bëra ishin teknike dhe nuk kishin për qëllim ndryshimin e vlerësimit të performancës, por vetëm harmonizimin me burimet zyrtare të të dhënave. Ndryshimi nga Komisioni ka ndodhur në fazën e verifikimit dhe asnjë e dhënë nuk është ndryshuar gjatë fazës së raportimit (Komisioni në fazën e raportimit ka qasje vetëm për leximin e të dhënave dhe jo për ndryshimin e tyre). Po ashtu të gjitha komunat kanë qenë të njoftuara në raportet preliminare, tek pjesa e komenteve për të dhënat e numrit të popullsisë që për bazë është marrë	Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm autorizon Komisionin për Vlerësimin e Performancës Komunale që të verifikojë dhe përpunojë të dhënat. Asnjë kompetencë sipas këtij vendimi dhe dokumenteve ligjore që rregullojnë fushën e performancës komunale nuk i jep komisionit të drejtë për unifikim apo çfarëdo ndërhyrjeje tjetër në të dhënat që raportohen nga komunat.

		Raporti i popullesise per vitin 2011. Deshmite mund ti gjeni ne email derguar nga MAPL tek Vjosa Bojku me daten 10/10/2025 "Ndryshimet ne te dhenat raportuese te komunave". Keto deshmi i keni te bashkangjitura perseri ne kopje fizike.	